



RAPORT MONITORIMI
Nëntor -Janar 2022

KONÇESIONI I CHECK UP



AUTOR
STIVEN SHALA

QENDRESA
QYTETARE



NED

www.qeverisja.qq.com.al

Kontroli Bazë Mjekësor ose Check Up	4
Sa i kushton qytetarëve shqiptarë ky koncesion?	6
Hetimi nga ana e SPAK për koncesionin e Check-Up	7
Ndërprerja e ofrimit të shërbimit gjatë pandemisë	8
Raportet e KLSH për koncesionin e check-up	8
Hetimi i Autoritetit të Konkurrencës për shërbim shëndetësor	10
Gjetjet kryesore	11
Rekomandime	12

Kryefjala e viteve të fundit në shëndetësi kanë qenë koncesionet. Shërbimi shëndetësor në Shqipëri gjendet sot i cënuar nga koncesionet ose të ashtuquajturat PPP. Fondet e shëndetësisë thithen nga koncesionet të cilat nuk arrijnë të ofrojnë shërbimin për të cilin paguhen. Në vitin 2020 shëndetësia ishte sektori i tretë publik me peshën më të lartë të kontratave të tipit Partneritet Publik Privat (PPP), pas energjisë dhe transportit.



Sot, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka 4 kontrata koncesionare:

1. Shërbimi i sterilizimit të instrumenteve kirurgjikale
2. Kontrolli Bazë Mjekësor, i njohur si Check-Up
3. Shërbimi i hemodializës
4. Ofrimi i shërbimeve laboratorike private në spitalet publike rajonale dhe në 2 spitale bashkiake

Këto 4 kontrata kanë një periudhë zbatimi 10-13 vjeçare dhe sipas përlogaritjeve **do t'i kushtojnë buxhetit 370 milionë euro**. Në vitin 2020, në buxhet parashikoheshin 32 milionë euro për këto koncesione. Në vitin 2019, pagesat për shërbimet PPP ishin 30 milionë euro. Zbatimi i kontratave të Partneritetit Publik-Privat (PPP) në shëndetësi filloi për herë të parë në vitin 2015 dhe, deri në maj të 2020-s, buxheti i shtetit ka paguar gjithsej rreth 100 milionë euro për koncesionet e shëndetësisë.

Partneriteti Publik-Privat është kritikuar haptazi nga institucione të shumta kombëtare e ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, për mos llogaritjen si duhet të raportit kosto-përfitimje prej tyre dhe lënien e rrezikut më shumë palës shtetërore se privatit të kontraktuar. Pavarësisht se zbatimi i PPP në Shqipëri nisi në 2015, vetëm në 2018, nga presioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar, filluan të bëhen publike pagesat që shkonin për këto shërbime.

Deri sot, shihet qartazi se kompanitë private kanë qenë të orientuara nga maksimizimi i fitimit e nuk kanë qenë të gatshme të ndërmarrin asnjë risk. Kontratat koncesionare janë lidhur pa studime të qarta fizibiliteti dhe


në këtë mënyrë, lënë shtigje të hapura për rritjen e financimeve në periudhat e mëvonshme. Në rastin e koncesionit të check-up, kompania e pezulloi përkohësisht aktivitetin në momentin kur shpërtheu pandemia e COVID-19 si dhe kompania është paguar për shërbimet e pakryera. Në rastin e kontratës së sterilizimit, koncesionari është paguar përtej parashikimeve fillestare.

Një raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit për koncesionin e ofrimit të shërbimeve laboratorike spitalore ka gjetur problematika të përbashkëta me koncesionin e sterilizimit duke vërejtur se janë planifikuar si duhen nevojat për shërbime laboratorike.

Sipas këtij institucioni, "Projekti koncesionar/PPP" vetëm në vitin e parë të implementimit të tij, sipas studimit të fizibilitetit, ka përcaktuar rritjen në financim të kërkuar me rreth 3.3 milionë euro nga situata ekzistuese. Sipas argumentimit të bërë në studimin e fizibilitetit, financimi aktual vlerësohet në rreth 5.4 milionë euro dhe shpenzimi i kërkuar për implementimin e PPP në vitin e parë vlerësohet në 8.7 milionë euro, nëse ky projekt do të realizohet duke argumentuar shtesën në financim prej 3.3 milionë eurosh.

Edhe kur konçensionet bëjnë sens dhe janë të nevojshme nga ana teknike, ato vijnë të shoqëruara me fatura shumë të larta. Pra automatikisht shikohet që qeveria dështon të menaxhojë sistemin shëndetësor dhe është e prirur t'i ofrojë këto kontrata në forma klienteliste. Në vend që fondet të shpenzohen me mençuri, aty ku duhen dhe si duhen, ato shkojnë direkt në xhepin e një grushti njerëzish duke privuar shqiptarët nga shërbimi i duhur.

➔ Kontrolli Bazë Mjekësor ose Check Up



Koncesioni për të cilën debatohet më shpesh është ai i **Kontrollit Bazë Mjekësor**, i njohur si Check-Up. Kjo kontratë e partneritetit publik privat është një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.

Kompania që e ofron sot këtë shërbim është "3P Life Logistic", një kompani e krijuar në vitin 2014 me kapital themeltar 250 mijë euro nën pronësinë e Marketing & Distribution 80% dhe T R I M E D 20%.

Qëndresa Qytetari iu drejtua me një kërkesë për informacion Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale ku parashtrroi 11 pyetje/kërkesa në lidhje me koncesionin e check-up. Kërkesa për informacion nga QQ u dërgua në datë 6 nëntor dhe ligji e parashikon që përgjigja të vijë jo më vonë se 10 ditë. E megjithatë përgjigja erdhi vetëm me 5 Janar.

Nëpërmjet kërkesës për informacion, ne i kërkuam Ministrisë së Shëndetësisë një kopje të kontratës por Ministria deklaroi se nuk disponon një kopje pasi Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) ka sekuestruar të gjithë dokumentet në kuadër të hetimit që po i bën këtij koncesioni.

Sipas versionit të kontratës fillestare që ndodhet në internet, koncesionari siguron të gjitha mjetet, paisjet dhe materialet mjekësore dhe jo-mjekësore për ofrimin e shërbimeve logjistike për zbatimin e Paketës të Kontrollit Mjekësor bazë të cilat do të kufizohen vetëm në matjen e parametrave biokimike të njeriut ku përfshihen: Formula e gjakut; Hb, HCT, MCV, MCH, MCHC; Kolesterol total, HDL kolesterol, LDL kolesterol, trigliceride; Glicemia; Feçe për gjak okult; Albuminuria, prania e qelizave, cilindrave, kristaleve në urinë; Bilirubinë totale dhe direkte, trasaminaza (SGPT, SGOT).

Konçensionari, sipas kontratës, merr përsipër të pajisë Qendrat Shëndetësore me mjetet, paisjet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e kontrollit bazë, transportin e kampioneve nga Qendra Shëndetësore në Laboratorët e ngritur nga konçensionari, ekzaminimin e kampioneve dhe hedhjen e rezultateve në Sistemin Software, pra duke synuar dixhitalizimin e të dhënave mjekësore.

Ne kërkuam të dijmë nga Ministria sa qendra shëndetësore ka vendi ynë dhe nëse në të gjitha këto qendra ofrohet shërbimi mjekësor bazë, pra sa qendra shëndetësore janë pajisur me mjete dhe materiale mjekësore. Ministria u mjaftua duke u përgjigjur se shërbimi objekt i kësaj kontrate shtrihet në të gjitha qendrat shëndetësore të shërbimit parësor që janë 407 të tilla.

Ky shërbim mbulon të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke përfshirë të gjithë shtetasit shqiptarë rezidentë që i përkasin grupmoshës nga 35-70 vjeç. Në momentin e nënshkrimit të kontratës grupmosha e synuar ishte nga 40 deri në 65 vjeç. Në një moment të dytë, u kërkuua zgjerimi i grupmoshës në 35-70 vjeç.

Sipas Ministrisë baza e përfituesve u zgjerua në përputhje me objektivin qeveritar të mbulimit shëndetësor universal. Ndërkohë duket se qeveria e ka harruar objektivin e mbulimit shëndetësor universal, edhe pse sipas Kryeministrit ky objektivi mbetet ylli polar i qeverisë. Në fushatën e Partisë

Socialiste në vitin 2013, Edi Rama premtonte qartazi se Partia Socialiste në qeveri do garantonte shëndetësi falas për të gjithë shqiptarët.

Nga ana tjetër ekspertët mendojnë se zgjerimi i grupmoshës u bë për të justifikuar numrin shumë të ulët të vizitave të kryera.

➔ Sa i kushton qytetarëve shqiptarë ky koncesion?

Sipas kontratës, ky shërbim ofrohet për një numër kontrollesh të llogaritur në **475 mijë kontrolle në vit**. Ama, gjatë vitit të parë të këtij partneriteti **vetëm 244 mijë shqiptarë e morën këtë shërbim**.


Pra, në praktikë, qytetarët shqiptarë për vitin 2015 e kanë paguar dyfish këtë shërbim që sipas qeverisë ofrohet falas. E nga ana tjetër koncesionari është paguar për kontrollin e 475 mijë qytetarëve, duke i kushtuar buxhetit 4.5 milionë euro. Në 2015 kompania investoi 2.8 milionë euro në laboratorë dhe qendra shëndetësore.

Kontrata e koncesionit do zgjasë për dhjetë vjet dhe në total, taksapaguesit shqiptarë do paguajnë 54 milionë euro për kompaninë që ofron shërbimin, pavarësisht se sa do jetë numri i analizave që kryhen.

Me anë kërkesës për informacion që Qëndresa Qytetare i dërgoi Ministrisë së Shëndetësisë u kërkuan të viheshin në dispozicion të gjithë dokumentet që lidhen me këtë koncesion.

Sipas pikës 14.3 të kontratës fillestare, autoriteti mund të monitorojë kryerjen e Shërbimeve nga Konçesionari. Në këtë kuadër ne kërkuam të dijmë nëse është kryer një monitorim i tillë dhe nëse po, kërkuam të na viheshin në dispozicion njoftimet me shkrim që i janë dhënë konçensionarit.

Sipas pikës 15, konçesionari ka një detyrim të vazhdueshëm për të identifikuar përmirësime të reja. Si pjesë e këtij detyrimi, Konçesionari duhet të identifikojë dhe raportojë tek Bordi i Menaxhimit çdo 6 muaj. Ne kërkuam të na viheshin në dispozicion këto raportime që nga data



efektive e kontratës e deri më sot si dhe të dinim nëse është ndërmarrë ndonjë veprim nga Autoriteti për të përfshirë përmirësimet e identifikuar nga Koncesionari.


Përgjigja e Ministrisë theksonte se Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka iniciuar një proces verifikimi/hetimor për këtë koncesion, i cili vijon të jetë në proces. Për këtë arsye, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përcjellë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar pranë këtij organi hetimor. Pikërisht për këtë arsye, sipas Ministrisë dokumentacioni i kërkuar do të përcillet sapo të ketë përfunduar procesi i verifikimit nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

→ Hetimi nga ana e SPAK për koncesionin e Check-Up

Qëndresa Qytetare i drejtoi një kërkesë për informacion edhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) për koncesionin e Check-Up. Në përgjigjen e dhënë nga institucioni thuhet se bazuar në kallëzimin e bërë nga Partia Demokratike, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedim penal për procedurën e realizimit të koncesionit të check – up, nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas SPAK, çështja është në hetim dhe nuk mund të jepen detaj rreth veprimeve të kryera.

Partia Demokratike depozitoi një kallëzim penal në Shkurt të 2020 për koncesionin e check up-it. Mes të akuzuarve janë dhe ish-Ministri i Shëndetësisë Ilir Beqaj, Ministria Manastirliu, aksionerja e kompanisë përfituese Vilma Nushi e zyrtarë të tjerë. Të paditurit ngarkohen me akuzat të ndryshme, që nga korrupsioni aktiv e pasiv, shpërdorimi i detyrës deri tek përfitimi i paligjshëm.

Sipas kallëzimit që mban firmën e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike, Ministria e Shëndetësisë shpalli fitues ofertuesin me çmimin më të lartë, duke sjellë dëm të lartë financiar për buxhetin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor. Gjithashtu, sipas Partisë Demokratike, funksionarët publikë nuk ushtruan kontrolle apo lejuan vazhdimin e shkeljeve të kontratës, duke sjellë një dëm të jashtëzakonshëm qytetarëve shqiptarë e financave të shtetit.



➔ Ndërprerja e ofrimit të shërbimit gjatë pandemisë

Koncesioni i check – up mori një vëmendje të shtuar gjatë pandemisë kur në mars të 2020 shërbimi i kontrollit mjekësor bazë u ndërpre. Zbatimi i kontratës u pezullua për arsye të forcës madhore (pandemi/epidemi) dhe masave të tjera shtrënguese që u morën në atë kohë për shkak të situatës së shkaktuar nga Covid-19.

Zyrtarisht Ministria deklaroi në atë periudhë së shërbimi do të rikthehej pas përfundimit të pandemisë, por ndërkohë shërbimi i kontrollit mjekësor bazë rifilloi në 1 shtator 2021 duke qenë se sipas Ministrisë programi është i rëndësishëm së veçantë për parandalimin e sëmundjeve kronike dhe monitorimin e pasojave post-covid.

Sipas mediave shërbimi u ndërpre me kërkesë të koncesionarit, ndërsa Ministria nuk iu përgjigj pyetjes sonë nëse ishte Autoriteti që e bëri kërkesën për ndërprerje.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale raportonte realizimin e 101 426 kontrolleve për vitin 2020, ndërkohë që kompania është paguar për 475 mijë kontrolle në vit.

Në përgjigjen që Ministria na dha, thuhet se nuk janë kryer pagesa për kohën e ndërprerjes/pezullimit të zbatimit të kontratës. Ndërkohë **koncesionari është paguar 2.9 milionë euro**. Sipas Ministrisë, një kontroll bazë mjekësor e ka koston 12.5 euro pra në total **kostoja për kontrollet për vitin 2020 është vetëm 1.27 milionë euro**.

➔ Raportet e KLSH për koncesionin e check-up

Edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit ka evidentuar parregullsi të shumta me koncesionin e check – up. Në raportet e KLSH, evidentohet qartazi se si koncesionari paguhet për shërbime të pakryera.

Në raportimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Kuvendin e Shqipërisë konsiderohen të paligjshme pagesat e TVSH që bëhen ndaj koncesioneve në shëndetësi.

"Konstatohet se edhe për vitin 2020 vijojnë të pranohen dhe likuidohen faturat tatimore mujore të Check-Up, lëshuar nga koncesionari, në vlerën totale 322 milion lekë në të cilën përfshihet edhe TVSH në masën 20% mbi vlerën e shërbimit shëndetësor, **ndërkohë që ky shërbim duhet**

të trajtohet si Furnizim i Përrjashtuar nga TVSH. Praktika vazhdon bazuar edhe në interpretimin e DPT, e cila ka referuar shërbimin si të tatueshëm”, thuhet në raportimin e KLSH.

Sipas KLSH neni 51 i ligjit për TVSH përcaktohen qartazi shërbimet që përjashtohen nga TVSH-ja.

Në ligjin për TVSH neni 51 përcakton përjashtimin nga TVSH-ja të disa aktiviteteve.

- Furnizimi i barnave, pajisjeve mjekësore të implantueshme aktive dhe pajisjeve mjekësore të implantueshme;
- Furnizimi i shërbimeve shëndetësore dhe veprimeve të lidhura ngushtë me to, që kanë për qëllim mbrojtjen e shëndetit të shtetasve, përfshirë parandalimin, diagnozën, trajtimin, kurimin e sëmundjes apo çrregullimeve shëndetësore dhe rehabilitimin, nga institucionet shëndetësore publike ose private, të njohura si të tilla nga autoriteti kompetent shëndetësor;
- Furnizimet e shërbimeve shëndetësore, të ofruara për qëllime të kujdesit për shëndetin, në kuadër të ushtrimit të profesionit mjekësor ose paramjekësor, të njohur si të fillë dhe të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për licencimin;
- Furnizimi i organeve, gjakut dhe të qumështit njerëzor;
- Furnizimet e shërbimeve shëndetësore, të kryera në kuadrin e profesionit të tyre nga stomatologët dhe laborantët dentarë;

Kontrolli i Lartë i Shtetit e cilësoi të papranueshëm faktin se vetëm koncesioni i Check UP merr 800 milionë lekë ose 6 milionë euro TVSH kundër përcaktimeve në ligjin mbi TVSH. KLSH konstaton me shqetësim trajtime të ndryshme për aplikimin e TVSH ndërmjet kontratave koncesionare, ndonëse shërbimet që ofrohen nga këto kontrata janë të përjashtuara nga TVSH.

Nga auditimi për kontratë koncesionare të check – up rezulton se aplikohet Tatim mbi Vlerën e Shtuar në masën 20% mbi çmimin e kontraktuar.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka kërkuar qeverisë të miratojë akte ligjore që rregullojnë procesin e furnizimit të shërbimit shëndetësor, të ofruar nga shoqëritë koncesionare, me qëllim shmangien e interpretimeve në këto shërbime.

➔ Hetimi i Autoritetit të Konkurrencës për shërbim shëndetësor

Një tjetër institucion që ka ndërmarrë një hetim për shërbimin shëndetësor është edhe Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Shqipërisë.

Qëndresa Qytetare iu drejtua me një kërkesë për informacion Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Shqipërisë për t'u njohur me vendimin nr. 552 të datës 04.10 .2018 "Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor", si dhe me dokumentin e hetimit të përgjithshëm në tregun e shërbimeve spitalore në Shqipëri.

Komisioni i Konkurrencës, vendosi hapjen e hetimit të përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i cili përfshinte periudhën kohore nga 1 janar 2016 deri në 30 shtator 2018. Sipas Komisionit, ky vendim erdhi si pasojë e informacioni të mangët nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ishte i mangët duke e bërë të pamundur vlerësimin e treguesve global të zhvillimit të konkurrencës në shërbimin shëndetësor. Për një analizë më të plotë dhe krahasimore, me vendimin Nr. 597, datë 19.02.2019 periudha e hetimit u ndryshua deri në 31 dhjetor 2018.

Nga analiza e informacionit të kontratave koncesionare, sipas Komisionit, është e vështirë të konkludohet për konkurrencën në shërbimin shëndetësor në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe eficensës ekonomike pasi shërbimet e ofrura nga këto koncesione kanë nevojë për një trajtim më të thelluar dhe më gjithëpërfshirës.

Në informacionet e kërkuara nga Autoriteti i Konkurrencës përfshihet edhe kërkesa drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për raportet vjetore të monitorimit për shërbimin check – up.

Sipas Raportit të Hetimit të Përgjithshëm nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, tregu i shërbimit të check up-it përbën një treg në strukturë monopolistike, me barriera në hyrje, ku oferta dhe kërkesa është inelastike dhe ku nuk ka konkurrencë potenciale.

Pavarisht se institucione të ndryshme kanë hapur hetime ose janë shprehur për parregullsitë, në media apo në politikë flitet shumë pak për koncesionin e check up. Qytetarëve i mungon informacioni për këtë shërbim e nga ana tjetër qeveria hiqet sikur po ofron shëndetësi falas, ndërkohë që pagesat për kompaninë janë totalisht të pajustificueshme në raportin me numrin jashtëzakonisht të ulët të vizitave.

→ Gjetjet kryesore



Në momentin e nënshkrimit të kontratës së koncesionit të Check-Up grupmosha e synuar ishte nga 40 deri në 65 vjeç. Në një moment të dytë, u kërkua zgjerimi i grupmoshës në 35-70 vjeç për të justifikuar numrin e ulët të vizitave të kryera.



Sipas kontratës, shërbimi i check - up ofrohet për një numër kontrollesh të llogaritur në 475 mijë kontrolle në vit por gjatë vitit të parë të këtij partneriteti vetëm 244 mijë shqiptarë e morën këtë shërbim. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale raportonte realizimin e 101 426 kontrolleve për vitin 2020, ndërkohë që kompania është paguar për 475 mijë kontrolle në vit.



Kontrata e koncesionit do zgjasë për dhjetë vjet dhe çdo vit pagesa do jetë jo më pak se 5.4 milionë euro. Pra në total, taksapaguesit shqiptarë do paguajnë 54 milionë euro për kompaninë që ofrojnë shërbimin e check - up, pavarësisht se sa do jetë numri i analizave që kryhen.



Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka iniciuar një proces verifikimi/hetimor për procedurën e realizimit të koncesionit të check-up.



Sipas KLSH konsiderohen të paligjshme pagesat e TVSH që bëhen ndaj koncesioneve në shëndetësi, ku vetëm në vitin 2020 janë likuiduar faturat tatimore në vlerën totale 322 milion lekë. Kontrolli i Lartë i Shtetit e cilëson të papranueshëm faktin se vetëm koncesioni i Check UP merr 800 milionë lekë ose 6 milionë euro TVSH kundër përcaktimeve në ligjin mbi TVSH.



Sipas Raportit të Hetimit të Përgjithshëm nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, tregu i shërbimit të check up-it përbën një treg në strukturë monopolistike, me barriera në hyrje, ku oferta dhe kërkesa është inelastike dhe ku nuk ka konkurrencë potenciale.

→ Rekomandime



Rishikimi i kontratave koncesionare me qëllim orientimin e parave të taksapaguesve drejt investimeve në sistemin shëndetësor.



Zgjerimi i grupmoshës në ofrimin e shërbimit mjekësor bazë, duke qenë se numri i vizitave mbetet tejet i ulët.



Hetimi i plotë të kontratave koncesionare në fushën e shëndetësisë.



Anullimin e pagesave të TVSH kundër përcaktimeve në ligjin mbi TVSH, duke qenë se shërbimet që ofrohen nga këto kontrata janë të përjashtuara nga TVSH.



Miratimi i akteve ligjore që rregullojnë procesin e furnizimit të shërbimit shëndetësor, të ofruar nga shoqëritë koncesionare, me qëllim shmangien e interpretimeve në këto shërbime.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.

QENDRESA
QYTETARE



NED

www.qeverisja.qq.com.al

RAPORT MONITORIMI
SHËNDETËSIA & MBROJTJA SOCIALE
Nentor - Janar 2022